

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Brukseli ia kujton Serbisë nevojën për zbatimin e sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë pas bisedës Vuçiç-Putin
ADRESA	https://dosja.al/bota/brukseli-ia-kujton-serbise-nevojen-per-zbatimin-e-sanksioneve-te-b-e-se-ndaj-i516526
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:26:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d0b9fe211e394bbad35260d042f5cb93e7bd0a9fc6fed0f5dd44df4ea66a087b
TEKSTI	4b07b23a758c5487dda136e455eb82441b1fffefef67b588f16c027b4bd4b06b
PAMJA	d956b527183a1503324e095ae66ea9d9ec2332802d2e422a75772e20989bc307

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	483ec9d8994969ae2159ed1ac450f1ee373851d6a6520f35e059af9ac6d746b8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/483ec9d8994969ae2159ed1ac450f1ee373851d6a6520f35e059af9ac6d746b8

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

1 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë punën për ligjin e pagave

3 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

5 ORE ME PARE

Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në fokus hetimi ndaj ish-drejtoreshës së SHISH dhe siguria e informacionit të klasifikuar

20 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

Bota

Brukseli ia kujton Serbisë nevojën për zbatimin e sanksioneve të BE-së ndaj Rusesë pas bisedës Vuçiç-Putin

Biseda u zhvillua një ditë para se Vuçiçi të jepte dorëheqje nga posti i presidentit të Serbisë, pasi është bartës i listës së Partisë Përparimtare Serbe (SNS) për postin e kryeministrit në zgjedhjet e parakohshme të 25 tetorit.



28 Shtator 2026, 15:10
Nga G.M



Flamuj të Bashkimit Evropian në selinë e Komisionit Evropian, në Bruksel. Fotografi nga arkivi.

Një ditë pasi presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, e zhvilloi një bisedë telefonike me presidentin rus, Vladimir Putin, Komisioni Evropian ia ka kujtuar Beogradit se duhet t'i përshatë më shumë politikat e tij me ato të Bashkimit Evropian, përfshirë zbatimin e sanksioneve ndaj Rusesë për shkak të luftës në Ukrainë.

"Si vend kandidat, nga Serbia pritet që politikat e saj t'i harmonizojë me objektivat e BE-së, përfshirë politikën energjetike dhe atë të jashtme, dhe të jetë një partnere e besueshme që ndjek të njëjtin drejtim strategjik", tha për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier.

Ai tha se qëndrimi i BE-së ndaj marrëdhënieve të vendeve candidate me Rusinë është "gjithmonë plotësisht i qartë".

"Marrëdhëniet me Rusinë nuk mund të zhvillohen sikur gjithçka të ishte si më parë me regjimin e Putinit, dhe kjo në hijen e luftës agresore, të paprovokuar dhe të pajustificuar të Rusesë kundër Ukrainës", tha Mercier.

Deklaratat e tij pasuan bisedën telefonike të 26 shtatorit mes Vuçiçit dhe Putinit. Biseda u zhvillua një ditë para se Vuçiçi të jepte dorëheqje nga posti i presidentit të Serbisë, pasi është bartës i listës së Partisë Përparimtare Serbe (SNS) për postin e kryeministrit në zgjedhjet e parakohshme të 25 tetorit.

Pas bisedës me Putinin, Vuçiç tha se beson se marrëveshja për furnizimin e Serbisë me gaz rus do të zgjatet. Marrëveshja e tanishme afatshkurtër skadon më 30 shtator. Serbia e importon nga Rusia më shumë se 80 përqind të gazit që konsumon.

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 13:01

FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

Beogradi nuk ka arritur marrëveshje afatgjatë për furnizimin me gaz që nga skadimi i kontratës së mëparshme trevjeçare, në verën e vitit 2025. Që atëherë, marrëveshjet me Moskën janë zgjatur për periudha të shkurtra. Marrëveshja e tanishme u zgjat në qershor për tre muaj. Komisioni Evropian tha se është në dijeni të bisedës mes Vuçiqit dhe Putinit.

Duke iu referuar deklaratës së Vuçiqit se presidenti i ardhshëm i Serbisë do të duhet të kujdeset për interesat e vendit dhe ta ruajnë një baraspeshë në raport me aktorët e rëndësishëm të politikës ndërkombëtare, Mercier rikujtoi detyrimet që Serbia i ka si vend kandidat për anëtarësim në BE.

Sipas tij, vendimi i Serbisë për të aplikuar për anëtarësim nënkupton zotimin për t'i harmonizuar politikat e saj me BE-në, përfshirë politikën e jashtme dhe të sigurisë.

"Përputhshmëria e Serbisë me Politikën tonë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë vazhdon të jetë dukshëm më e ulët sesa te vendet e tjera candidate në Ballkanin Perëndimor", tha Mercier.

Ai shtoi se Serbia duhet, si prioritet, t'i intensifikojë përpjekjet për një nivel "më të qëndrueshëm dhe dukshëm më të lartë" të harmonizimit me politikën e BE-së, përfshirë sanksionet ndaj Rusisë.

"Duam të jemi në gjendje të llogarisim në Serbinë si një partnere të besueshme", tha ai.

Komisioni Evropian tha se BE-ja po e rrit mbështetjen për vendet e Ballkanit Perëndimor në fushën e sigurisë energjetike, me synim uljen e varësisë nga lëndët djegëse fosile dhe diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit. Sipas Mercier, kjo do t'u mundësonte vendeve të rajonit integrim më të mirë të rrjeteve energjetike dhe qasje në energji nga burime të ndryshme.

"Pas fillimit të luftës agresore të Rusisë kundër Ukrainës, pamë se sa e rëndësishme është kjo dhe çfarë problemesh mund të shkaktojë për çdo vend evropian, përfshirë Serbinë", tha ai.

BE-ja synon që deri në fund të vitit të ardhshëm të ndërpresë gradualisht dhe në mënyrë efektive importin e gazit dhe naftës ruse, ndërsa nga vendet candidate pret që t'i përshtatin politikat e tyre me këtë objektiv.

Negociatat e Serbisë për anëtarësim në BE kanë ngecur, ndër të tjera, edhe për shkak se ajo nuk e ka përshtatur mjaftueshëm politikën e saj të jashtme me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së. Serbia nuk u është bashkuar sanksioneve të BE-së kundër Rusisë pas pushtimit të Ukrainës. Niveli i saj i përputhshmërisë me politikën e sanksioneve të BE-së është rreth 60 për qind./REL

aleksander vucic vladimir putin rel

Sondazh

Poll

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 11:21

"Nuk mërzitem kurrë me Shqipërinë", Rama ndërpret fjalën e raportuesit për Shqipërinë në PE: Aman, s'i lë dot gjermanët të presin

më të klikuarat

Labirinti i errët i Edi Ramës

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

WSJ zbardh prapaskenat: Ja si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 mld \$ në Shqipëri

I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elbasanliu Salvatore Aliu, që kërkohet nga SPAK

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow.

SHBA dhe Kina ulin tarifat për 60 miliardë dollarë mallra, një hap drejt zbutjes së tensioneve tregtare mes dy ekonomive botërore

Xi Jinping dhe Donald Trump SHBA- Shtetet e Bashkuara dhe Kina kanë arritur marrëveshje për uljen reciproke të tarifave për mallra...

VIDEO/ Spektakël mbresëlënës nga shpërthimi i vullkanit Kilauea, lava ndriçon qiellin e natës

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 14:16

Pesë britanikë arrestohen pranë bazës ajrore RAF Fairford, dyshohen për përgatitje të një akti terrorist

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 14:04

Dyshohet se i mori telefonin një personi dhe e hodhi lumin Danub/ Parlamenti hungarez i heq imunitetin kryeministrit Péter Magyar

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 13:56

Simbol i diplomacisë/ Ping Ping dhe Fu Shuang, kush janë pandat e reja që mbërritën në Atlanta?

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 13:43

[Bota](#)

28 Shtator 2026, 13:26

FOTOGALERI/ Pamje magjike nga Mbretëria e Bashkuar, Hëna e plotë e shtatorit dhuron spektakël në qiell

"Riciklimi i së kaluarës" në fushatën zgjedhore në Bosnje

Bota

28 Shtator 2026, 12:46

Pas dorëheqjes së Vuçiç, Ana Brnabic merr detyrën si Presidente e Serbisë

Bota

28 Shtator 2026, 12:23

Skandal financiar në Turqi, zyrtarja e lartë e AKP-së jep dorëheqjen

Bota


28 Shtator 2026, 09:53

VIDEO/ Skandal në Teheran, nis hetimi ndaj trupës teatrore pasi aktorja mbështeti kokën në gjoksin e kolegut

Bota

28 Shtator 2026, 09:31

MË SHUMË



Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësjellësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve

Tentuan të mashtronin Armand Dukën në emër të Taulant Ballës, në pranga sekserët e Florian Gjergjit

Debati ironik në Komision, Korreshi: Të ndryshohet rendi i ditës i nderuar kryetar

Mashtruan një të moshuar në emër të Armand Dukës, në pranga 2 sekserët e Florian Gjergjit...

Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësjellësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve

▶ Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MEMBERSHIP INFLA Mediadesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.